



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.343/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Turk Eximbank”, Tyrkye Ihracat Kredi Bankasi A.S, me seli në adresën Milli Mydafaad Cad. Numër 20, 06100 Bankanliklar, Ankara Turqi, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu&Qerkini” shpk, me seli në lagjen Veternik Kompleksi Banesor EXDC, Blloku 12, Kati V, nr.10 në Prishtinë, kundër debitorit NTP “ELIF 19” O.P, me pronar E.Gj., R.B. dhe M.M., të tre nga Prizreni rr.” „,” nr.24, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP.nr.1962/16 i datës 05.12.2017, me datë 25.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kreditorit “Turk Eximbank”, Tyrkye Ihracat Kredi Bankasi A.S, me seli në adresën Milli Mydafaad Cad. Numër 20, 06100 Bankanliklar-Ankara,Turqi, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, CP.nr.1962/16 i datës 05.12.2017, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.1962/16 dt.05.12.2017, në pjesën I të dispozitivit ka vendosur që Prapësimi i ushtruar i debitorit NTP “Elif 19” O.P, me pronar E.Gj., R.B. dhe M.M., të tre nga Prizreni, kundër aktvendimit për përmbartim CP.nr.1962/16 dt.18.08.2016 i Gjykatës Themelore në Prizren, Miratohet pjesërisht si i bazuar për një pjesë të parashkruar të detyrimit në të holla, në shumën prej 55,028.57€, për faturat nr.59 dt.17.12.2010 dhe fatura nr.116 dt.24.12.2010, dhe se ky aktvendim për përmbartim për këtë pjesë të këtij detyrimi në të holla anulohet-Shfuqizohet pjesërisht derisa propozimi për përmbartim, i kreditorit “Turk Eximbank”, Tyrkye Ihracat Kredi Bankasi A.S, me seli në adresën Milli Mydafaad Cad. Numër 20, 06100 Bankanliklar, Ankara Turqi i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu&Qerkini” shpk, me seli në lagjen Veternik Kompleksi Banesor EXDC, Blloku 12, Kati V, nr.10 në Prishtinë, që debitori i përmbartimit NTP “Elif 19” O.P, me pronar E.Gj., R.B. dhe M.M., të tre nga Prizreni rr.” „,” nr.24, detyrohet që të paguaj pjesën e parashkruar të detyrimit në të holla në shumën prej 73,040.17 euro, e që rrjedh nga dokumenti i besueshëm i përmbartimit –Fatura nr.59 dt.17.12.2010,

nr. 116 dt.24.12.2020 dhe nr.289 dt.27.01.2011, për pagesat e faturave për borxhin e cekur më lartë, Refuzohet pjesërisht si i pabazuar . Ndërsa në pjesën e II te dispozitivit te këtij aktvendimi Prapësimi i ushtruar nga debitorit i përmbarimit NTP “Elif 19” O.P, me pronar E.Gj., R.B. dhe M.M., te tre nga Prizreni, kundër aktvendimit për përmbarim, CP.nr.1962/16 dt.18.08.2016 te Gjykatës Themelore ne Prizren, Refuzohet pjesërisht si i pabazuar për pjesën tjetër te detyrimit ne te holla ne shumen e pa parashkruar prej 25,511.50 euro, për faturën nr.289 dt.27.01.2011 nga detyrimi ne te holla për shumen prej 73,040.17 euro, e qe rrjedh nga dokumenti i besueshëm i përmbarimit-Faturat nr. 59, 116 dhe 289, për pagesat e borxhit te cekura me lart , i njëjti aktvendim për përmbarim për ketë pjesë te pa parashkruar te detyrimit në të holla Mbetet pjesërisht në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, pa precizuar bazat e veçanta ligjore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e kreditorit ta aprovoj ne tërësi si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj, ashtu që aktvendimi për lejimin e përmbarimit të mbetet ne fuqi si dhe të detyrohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Turk Eximbank”, Tyrkye Ihracat Kredi Bankasi A.S, me seli ne adresën Milli Mydafa Cad. Numër 20, 06100 Bankanliklar, Ankara Turqi, me datën 10.12.2013, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit NTP “Elif 19” O.P, me pronar E.Gj., R.B. dhe M.M., te tre nga Prizreni rr.” „,” nr.24, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave nr. 59 dt.17.12.2010,nr.116 dt.24.12.2010 dhe nr.289 dt.27.01.2011. Gjykata Themelore ne Prizren sipas propozimit te kreditorit, me aktvendimin për përmbarim E.nr.1962/16 dt.18.08.2016, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te detyrimit nga faturat ti paguaj shumën prej 73,040.17 euro, me kamatë prej 3.5% nga dita e arritjes për pagesë te secilës faturë veç e veç e deri ne pagesën definitive.

Kundër urdhrorit përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se lejimi i aktvendimit për përmbarim ne rastin konkret është joligjor andaj gjykata duhet te anuloj te gjitha veprimet e ndërmarra për shkak te jo kompetencës lëndore. Meqë përmbarimi ka te bëjë me dokumentin e huaj ne rastin konkret te dokumentit nga Republika e Turqisë, përmbarimi i dokumenteve te huaja përcaktohet sipas nenit 11 te LPP-së, e cila thekson pos tjerash se dokumenti përmbarimor i huaj duhet te plotësoj kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbarim. Shton se debitori nuk i ka borxh kreditorit meqë i ka bërë pagesat e

rregullta dhe ne këtë mënyrë e ka shlyer ne tërësi borxhin, propozon që gjykata ta anuloj vendimin dhe te gjitha veprimet tjera te ndërmarra lidhur me propozimin.

Ndaj prapësimin te debitorit, ka ushtruar përgjigje kreditori, me arsyetimin se pretendimet e debitorit ne prapësim janë te pabazuara, dhe sa i përket pretendimit te debitorit se e ka paguar borxhin nuk qëndron sepse i njëjti ka sjell si prove disa fatura tjera me te cilat lehtë mund të vërehet se nuk janë faturat te cilat janë dorëzuar ne propozimin për përmbarim, kreditori propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta detyroj debitorin që kreditorit t,ia paguaj shpenzimet e procedurës sipas ligjit.

Gjykata Themelore në Prizren, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin CP.nr.1962/16 dt.05.12.2017, me të cilin e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka konstatuar se bazuar ne faturat nr. 59 dt.17.12.2010 dhe 116 dt.24.12.2020 ne shumen prej 55,028.57 euro, borxhi nga këto fatura është parashkruar sepse pala kreditore propozimin për përmbarim e ka bere me datën 10.12.2013 e ashtu qe me mosbërjen e pagesave te cekura me larte, e me këto veprime ka ardhur edhe te parashkrimi pjesës se detyrimit për këto fatura, ashtu që kreditori me rastin e parashkrimit te kërkesës nga këto fatura ka humbur te drejtën e te kërkuarit përmes rrugës gjyqësore përmbaruese për realizimin e pjesës se detyrimit ne te holla për faturat nr. 59 dhe 116 për shumen prej 55.028.57 euro. Ndërsa gjykata ka gjetur se detyrimi nga fatura nr.289 dt.27.01.2011, bazuar ne nenin 374 te LMD, konstaton se nuk ka kaluar afati i parashkrimit dhe se shuma nga kjo faturë është e pa parashkruar për pjesën e detyrimit prej 28,511.50 euro. Gjykata bazuar ne këto arsye ka gjetur se prapësimi debitorit është pjesërisht i bazuar për një pjesë te detyrimit dhe është pjesërisht i pabazuar për pjesën tjetër te detyrimit, andaj edhe ka vendosur ashtu si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është kontradiktor dhe i pa ekzekutueshëm sepse ne dispozitiv te aktvendimit të saj edhe pse ne fakt e njëjta i referohet

shumës prej 73,040.17 euro, vlerësuar shumave të përcaktuara ne dispozitiv të aktvendimit del se ka llogaritur shumën prej 83,540.07 euro, nga del se nuk e ka marrë parasysht fare edhe konstatimin e kreditorit ne propozimin për përmbarrim se debitori ka paguar një pjesë të detyrimit. Në anën tjetër gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk e ka marrë parasysht dhe njëherit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm – faturat përmbarrimore nr.59 dt.17.12.2010,nr.116 dt.24.12.2010 dhe nr.289 dt.27.01.2011, në bazë të së cilave është lejuar përmbarrimi, nëse të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e LPP-së. Kjo pasi që në rastin konkret kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, të cilat fatura në rastin konkret i takojnë një subjekti të shtetit tjetër.

Me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, është paraparë se: “1. Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. *faturat*”, ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen është përcaktuar shprehimisht se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Me nenin 37 të LPP-së, është paraparë se: “*Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”. Kurse me nenin 38 të LPP-së, decidivisht përcaktohet se: “*Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit*”.

Së këndejmi, zbatimi i dokumentit të besueshëm të një vendi tjetër nga Republika e Kosovës i nënshtrohet aplikimit të dispozitës së nenit 11 të LPP-së, e cila përcakton se: “*Përmbarrimi i dokumentit të huaj përmbarrimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbarrimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbarrim*”. Në rastin konkret, shihet qartë se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit mbështetet në fatura të lëshuara nga subjekti juridik i shtetit të huaj, që nënkupton se detyrimi i referohet legjislacionit të vendit të huaj.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i dhomës së shkallës së parë duhet prishur dhe çështja t’i kthehet Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ashtu që pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, edhe njëherë të vlerësoj nëse dokumenti përmbarrues – faturat i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Ligjit të Procedurës

Përmbaremore, e konkretisht nëse në rastin konkret faturat e huaja nga një subjekt i shtetit tjetër, si të tilla a mund ti nënshtrohen përmbaremit konform dispozitave të LPP-së.

Kompetenca e Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbaremore “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.343/23 me datë 25.01.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha